



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Shkollat e mesme artistike (kurrikula e re)

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga tri pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I

Udhëtimet e Guliverit: Argëtim apo egërsi?

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë
Pyetja 8	C	1 pikë

Pyetja 9 (a) 2 pikë**Argumentet**

- Ishte kohë eksplorimesh. Shumë njerëz nuk e njihnin jetën në vende të tjera të botës, ndaj iu besonin rrëfimeve të eksploruesve.
- Dëshmia e kapitenit, që pohonte se e njihnte personalisht kapiten Guliverin.
- Rrëfimi në vetën e parë dhe shënimi në kopertinën e librit, si dhe mungesa e emrit të autorit.

2 pikë Nëse rendisin dy argumente.

OSE

1 pikë Nëse rendit vetëm një argument.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 (b) 1 pikë

1 pikë Nëse shpjegon se cili nga dy argumentet e përzgjedhura i duket më bindës dhe pse.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Për të dalluar citimet e marra nga burime të ndryshme, si tekste referuese.

1 pikë Nëse tregon se për ç'qëllim i ka futur autori i shkrimit disa fjalë ose fjali midis thonjzave.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 8 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se cilin tip libri preferon, atë që të argëton apo atë që të bën të mendosh;
- përdor detaje mbështetëse, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë**1 pikë Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.

PJESA II**Migjeni*****Nën flamujt e melankolisë***

Pyetja 12	C	1 pikë
Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë

Pyetja 16 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Atmosfera e kësaj poezie sundohet nga trishtimi, melankolia, një gjendje e tejzgjatur që nuk mbaron.
- Kjo gjendje është shkaktuar nga mungesa e veprimit, dëshira për të bërë diçka të re, për të ndryshuar, për të reaguuar.

1 pikë Nëse tregon se cila është atmosfera që sundon poezinë.**DHE****1 pikë** Nëse tregon se çfarë e ka shkaktuar atë.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 16 (b) 3 pikë**Simboli**

- Në këtë poezi flamuri shfaqet si simbol i një jete të trishtueshme njerëzore, pa fitore, pa qëndresë, i një jete që thjesht vegjeton.
- Në simbolikën tradicionale flamuri është simbol qëndrese, fitoreje, lirie. Por ai nuk shfaqet i tillë në këtë poezi. Simbolika vjen e përmbysur.
- Migjeni e sjell të përmbysur këtë simbolikë, pasi nuk mund të flitet për fitore në një vend të pushtuar nga kotësia, ku jeta është e trishtueshme, ku idealet kanë humbur.

1 pikë Nëse tregon simbolikën që mbart flamuri në këtë poezi.

DHE

1 pikë Nëse tregon ndryshimin e kësaj simbolike nga ajo tradicionale.

DHE

1 pikë Nëse tregon pse Migjeni e ka sjellë nën këtë këndvështrim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 2 pikë**Ironia**

- Përpyekjet bëhen për të lindur një xhind, por lind një mi.

OSE

- *Dhe kështu kjo komedi
na plas dellin e gazit,
nsa prej marazit
pëlcasim...*

Shpjegimi

- Ironia tregon absurditetin e një shoqërie, që nuk ndërton dot asgjë të re dhe, si rrjedhim, nuk meriton një xhind, por një mi.
- Ironia i drejtohet bashkëkombësve dhe vetes. Pasi askush nuk është në gjendje të ndryshojë gjë edhe ai bashkë me ta.

1 pikë Nëse zbulon një rast të përdorimit të ironisë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon se ku qëndron ironia.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 18 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Poeti po përjeton një dramë, pasi ai e kupton gjendjen e mjerueshme, është i aftë ta konstatojë atë, por e di shumë mirë se nuk ka forcë të ndryshojë gjë. Ai e ndjen veten të pashpresë, të pafuqi dhe kjo i shkakton dhe një dramë të fuqishme. Poeti është i ndërgjegjshëm për pafuqinë e vet.

Ilustrimet

- këtu s'ndërtohet asgjë e re
 ➤ kudo valojnë flamujt e një melankolije të trishtueshme
 ➤ shenjë jetese

1 pikë Nëse analizon pse poeti po përjeton një dramë të madhe.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e ilustron me vargje ose detaje nga poezia.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 19 **2 pikë****Vargjet:**

*Dhe kështu kjo komedi
 na plas dellin e gazit,
 nsa prej marazit
 pëlcasim.*

- Në këtë rast vargu del në vetën e parë shumës (Migjeni bëhet njësh me bashkëkombësit, shkrihet me ta).

1 pikë Nëse identifikon vargjet ku trishtimi i përgjithshëm merr nota personale.

DHE

1 pikë Nëse tregon si jepet gjuhësisht ky kalim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA III**Markez*****Njëqind vjet vetmi***

Pyetja 20 **D** **1 pikë**

Pyetja 21 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Mungesa e padurimit është shenjë që lidhja nuk do të jetë e qëndrueshme. Amarantës i mungon dëshira për ta parë, takuar Krespin. Ajo çdo takim me të e përjeton si diçka të zakonshme, pa emocion, pa ndjenjë. Ajo është shumë e ftohtë dhe e përmbajtur.
- Marrëdhënia shfaqet e ftohtë. Nuk ka asnjë shkëndijë, as padurim. Mungon intimiteti.

2 pikë Nëse shpjegon plotësisht pse mungesa e padurimit është shenjë paralajmëruese.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht pse mungesa e padurimit është shenjë paralajmëruese.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (a) **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Pietro Krespi e përjeton ndjenjën e dashurisë dhe vdes për të. Amaranta nuk provon asnjë ndjenjë, asnjë emocion. Nuk dashuron dot.

1 pikë Nëse tregon ndryshimin më të madh që ekziston midis dy të rinjve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 (b) **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Mendoj se po. Çdo gjë vjen shumë rozë. Ai çdo gjë, dhe dashurinë dhe vuajtjen e përjeton në mënyrë paksa të tepruar, me lule, muzikë, parfume. Nuk ka asgjë burrërore, të fortë, prej mashkulli tek ai, përkundrazi. Pietro Krespi shfaqet shumë delikat, i brishtë, i ndjeshëm, deri në patetizëm.
- Jo. S'më duket e tepruar. Ai wshtw italian, shumëw natyrw poetike. Varet nga kwndvshtrimi si i shikon gjërat.

Ilustrimet:

- pamje çiftesh të dashuruar;
- parqe të vetmuar;
- zemrash të shpuara me shigjetë;
- fjongo të arta që i mbanin pëllumbat në sqep;
- Nisi të qante me ngashërim (vuajtja);
- sa s'i theu gishtërinjtë e dorës nga dëshpërimi;
- duke i futur në zarfa o petale lulësh, o flutura të thara;
- zërin e prushtë të një mashkulli;
- Etj.

2 pikë Nëse argumenton plotësisht mendimin në lidhje me Pietri Krespin.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e mbështet me detaje nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Po. Ftohtësia, përçmimi, krenaria e saj e vranë djaloshin e dashuruar. Ajo i dha shpresë për shumë kohë dhe më pas i tha se nuk do të martohej me të. Pietro ishte shumë i ndjeshëm dhe mesa duket nuk e përballoi dot humbjen e saj dhe vrau veten nga dëshpërimi..
- Po. Pietro ishte nga natyra shumë më i ndjeshëm seç duhej dhe refuzimi i saj e plagosi keq natyrën e tij delikate.

Ilustrime

- Të gjithë e dëgjuan kitarën e Krespit, vetëm Amaranta nuk reagoi;
- por ajo ia kthente ato letra pa i hapur fare;
- Ai la pas dore gjithçka;
- Unë as e vdekur nuk do të martohej me ty;
- brejtjet e padurueshme të ndërgjegjes.

1 pikë Nëse shpreh mendimin se a është Amaranta shkaktare e vdekjes së Krespit.

DHE

1 pikë Nëse e ilustron mendimin me shembuj nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (b) 2 pikë

- Amaranta e djeg dorën si shenjë keqardhjeje, për të qetësuar ndërgjegjen. Ajo thellë e di që ka shkaktuar vdekjen e një njeriu.

OSE

- Është shkaktare e tragjedisë që ndodhi. Kjo është më e pakta që mund të bënte, të ndiente sadopak dhimbje, pasi ishte e ftohtë ndaj ndjenjave të tjera.

Simbolika

- Shenja e asaj që shkaktoi do t'i mbetet vrugë në zemër dhe në ndërgjegje për të gjithë jetën. Është e vetmja gjë që mund të bënte për Krespin, pas asaj që i shkaktoi.
- Simbol i zisë që do të ndiente në shpirt, i ndjesisë së fajit.

1 pikë Nëse shpjegon pse Amaranta djeg dorën.

DHE

1 pikë Nëse zberthen kuptimin simbolik të fashës së zezë në dorën e saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (c) 1 pikë

Autori nuk thotë kujtim tragjik, kujtim i trishtuar, por i mynxyrshëm. Fjala e përzgjedhur mbart një ngarkesë shumë të madhe emocionale. Kujtimi që ajo kërkon ta heqë nga mendja është i kobshëm, pasi i kujton tragjedinë që ka shkaktuar.

1 pikë Nëse shpjegon forcën shprehëse të fjalës *i mynxyrshëm*.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Janë të ndjeshëm.
- Ndjeshmëria ndaj së bukurës.

1 pikë Nëse tregon karakteristikën e banorëve që shfaqet në fragment.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **2 pikë****Model përgjigjeje****Situata**

- Kur Amaranta e refuzon papritur kërkesën e Krespit.

Shpjegimi

- Deri në këtë moment Markezi e kishte bërë lexuesin të besonte se kjo lidhje do të kurorëzohej me martesë. Befas situata ndryshon. Është veçori e stilit për të mos i parashikuar ngjarjet, për t'i bërë befasuese. Kjo mënyrë tërheq më shumë vëmendjen, e bën veprën më interesante, pasi është e vështirë të parashikosh se çfarë mund të ndodhë.

1 pikë Nëse identifikon rastin kur situata përmbysset papritur.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.